



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS PËR
VITIN 2024**

Prishtinë, shkurt 2025

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË OSK-SË

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të OSK-së,

Në vitin 2024, Oda e Stomatologëve të Kosovës ka vazhduar të përmbushë angazhimet e saj në fushat kyçe, duke siguruar progres dhe zhvillim në sektorin e stomatologjisë. Një raport ky gjithpërfshirës, që përfshin zhvillimet më të rëndësishme në Odën e Stomatologëve të Kosovës duke përfshirë punën e të gjitha organeve të OSK-së.

Në përgjithësi, ky vit ka qenë i suksesshëm për OSK-në, me rezultate pozitive, ndërsa angazhimi për përmirësim do të vazhdon edhe për vitin 2025. Krahas punës dhe angazhimeve nga detyra e të parit të OSK-së, me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur ne kemi arritur që gjatë kësaj periudhe njëvjeçare të realizojmë me sukses objektivat e parapara sipas planit të punës.

Prandaj, shfrytëzoj rastin që t'ju falenderoj për angazhimin, mbështetjen dhe përkrahjen të pazërvë dhënë Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Me respekt,



Prof. Dr. Blerim Kamberi

Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| <i>Hyrje</i> | 3 |
| <i>Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënia për punën e organeve të Odës</i> | 4 |
| <i>Azburnimi në baza mujore i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrit të licencave të stomatologëve</i> | 4 |
| <i>Plotësim / ndryshimi i akteve juridike të OSK-së</i> | 4 |
| <i>Puna e organeve dhe komisioneve të përbershme të Odës</i> | 4 |
| <i>Regjistrimi, licencimi dhe rilicencimi i stomatologëve</i> | 6 |
| <i>Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)</i> | 7 |
| <i>Çështjet etike</i> | 11 |
| <i>Solidariteti dhe ndihma reciproke</i> | 12 |
| <i>Komisioni për buxhet dhe financa</i> | 12 |
| <i>Memorandumet e bashkëpunimit</i> | 12 |
| <i>Aktivitetet tjera</i> | 13 |
| <i>Raporti i pasqyrave financiare</i> | 19 |

HYRJE

Oda e Stomatologëve të Kosovës në përputhje me mandatin e saj ligjor të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutit të OSK-së, si dhe planit vjetor të punës, ka realizuar aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2024. Raporti në vijim pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara që njëherit kanë qenë të përfshira në planin vjetor të punës së OSK-së.

Në vijim janë paraqitur objektivat të cilat kanë qenë të planifikuara për vitin 2024.

- Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënja për punën e Odës,
- Asistenca në zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin e kapacitetit të EVP-së dhe në regjistrimin, licencimin/rilicencimin e stomatologëve,
- Azhurnimi në baza mujore i regjstrit të anëtarësisë dhe regjstrit të licencave të stomatologëve si dhe lëshimin e faksimileve unike,
- Plotësim /ndryshimi i akteve juridike të OSK-së,
- Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK,
- Organizimi i simpoziumit profesional – “Identifikimi dhe menaxhimi i faktorëve të rrezikut në praktikën stomatologjike”,
- Mbajtja e ligjëratave profesionale në kuadër të EVP-s për vitin 2024 në 7 (shtatë) Qendra Rajonale të Kosovës,
- Mbrojtja e interesave profesionale, konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët e Odës,
- Realizimi i projekt-hulumtimit për “Emergjencat mjekësore në praktikën stomatologjike - sondazh i stomatologëve Kosovar”
- Organizimi i punëtorive dhe tryezave profesionale me qëllim të identifikimit të problemeve, shqetësimeve të komunitetit të stomatologëve si dhe ngritjes së nivelit të tyre profesional,
- Mbështetja financiare për anëtarët e Odës në rastet e sëmundjeve të rënda nga fondi i veçantë i solidaritetit dhe ndihmës reciproke,
- Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare,
- Bashkëpunimi me odat tjera të profesionistëve shëndetësor,
- Vazhdimësia e bashkëpunimit me FDI dhe European Regional Organization (ERO),
- Auditimi financiar dhe funksional për vitin 2024.

1. VAZHDIMËSIA E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIA PËR PUNËN E ORGANEVE TË ODËS

Transparenca dhe llogaridhënia për punën e organeve të Odës ka qenë një nga prioritetet tona kryesore gjatë vitit 2024. Angazhimi ynë për transparencë ka përfshirë publikimin e informacionit në mënyrë të rregullt nëpërmjet Web-faqes së Odës, për t'u siguruar që anëtarët tanë të jenë të informuar për të gjitha vendimet dhe çështjet tjera relevante në baza të rregullta, e të cilat do të nxisin në vazhdimësi llogaridhënien dhe transparencën e punës së organeve të Odës.

2. AZHURNIMI NË BAZA MUJORE I REGJISTRIT TË ANËTARËSISË DHE REGJISTRIT TË LICENCAVE TË STOMATOLOGËVE

Në baza mujore është bërë përditësimi i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrit të licencave valide të stomatologëve në nivel vendi në Webfaqen zyrtare të Odës.

Deri në fund të viti 2024, Oda e Stomatologëve të Kosovës ka numëruar 2628 anëtarë të anëtarësuar në odë dhe 2517 stomatolog me licencë valide të punës.

3. PLOTËSIM /NDRYSHIMI I AKTEVE JURIDIKE TË OSK-SË

Gjatë vitit 2024 është bërë plotësim/ndryshimi i këtyre akteve normative:

- Kodi Etik dhe Deontologjia Stomatologjike
- Rregullorja për solidaritet dhe ndihme reciproke
- Rregullorja për lejimin e hulumtimeve shkencore biomjeksore
- Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të OSK-së
- Vendim i Kuvendit për plotësim-ndryshimin e taksave administrative.

4. PUNA E ORGANEVE DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË ODËS

4.1 KUVENDI I OSK-SË gjatë vitit 2024 ka mbajtur dy mbledhje dhe janë miratuar:

- Rregullorja për lejimin e hulumtimeve shkencore biomjeksore;
- Planit të punës për vitin 2024;
- Projekt buxheti i OSK-së për vitin 2024;
- Raporti financiar për vitin 2023;
- Raportet e punës së organeve të OSK-së për vitin 2023;
- Ndarja e mjeteve financiare për formën elektronike të doracakut në gjuhën shqipe "Emergjencat mjekësore në praktikën stomatologjike";

- Rregullorja për Solidaritet dhe ndihmë reciproke për anëtarët e OSK-së;
- Plotësim ndryshimi i vendimit nr.2036 të datës 02.11.2021 për caktimin e lartësisë së taksave administrative të OSK-së;
- Kodi Etik dhe Deontologjia Stomatologjike.

4.2 KËSHILLI DREJTUES ka mbajtur 11 (njëmbëdhjetë mbledhje) me ç'rast janë marrë vendime: të ndryshme, disa nga to po i përmendim si në vijim:



- Miratimi i raportit financiar për periudhën Tetor – Dhjetor 2023, i Odës së Stomatologëve të Kosovës, i paraqitur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i OSK-së;
- Miratimi i raportit financiar për periudhën Janar- Dhjetor 2023;
- Miratimi i raporteve të punës së organeve të OSK-së për vitin 2023;
- Miratimi i planit vjetor të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional të cilat do të organizohen për anëtarët e OSK-së për vitin 2024;
- Miratimi i propozimit për planin e punës së Odës së Stomatologëve të Kosovës për vitin 2024;
- Miratimi i Draft Rregullores për lejimin e hulumtimeve shkencore biomjekësore;
- Miratimi i raportit financiar i Këshillit Organizativ mbi shpenzimet për organizimin e simpoziumit “ Identifikimi dhe menaxhimi i faktorëve të rrezikut në praktikën stomatologjike” të mbajtur me datë 20 Prill 2024;
- Miratimi i raportit financiar për periudhën Janar- Mars 2024;
- Miratimi i raporteve të punës së organeve të OSK-së për periudhën 6 mujore (Janar- Qershor 2024);
- Miratimi i raportit financiar për periudhën TM2 (Prill – Qershor 2024);
- Miratimi i raportit financiar për periudhën 6 mujore (Janar – Qershor 2024);
- Miratimi i Draft Rregullores për solidaritet dhe ndihmë reciproke e OSK-së;
- Plotësim-ndryshimi i taksës administrative vjetore për anëtarësim të anëtarëve të OSK-së, të cilët janë regjistruar në vitet paraprake në përputhje me vendimin e Kuvendit nr.prot. 2036 të datës 02.11.2021, paguhet deri me 30 Qershor të vitit;
- Miratimi i raportit financiar për periudhën 3 mujore (Korrik –Shtator 2024);
- Miratimi i Draft Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të OSK-së;
- Miratimi i Draft Kodit Etik dhe Deontologjisë Stomatologjike;
- Vendim për shpalljen e Konkursit Publik për Sekretar të Përgjithshëm dhe asistent për shërbime të përgjithshme;
- Vendim për emërimin e sekretarit të përgjithshëm të OSK-së;
- Vendim për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.prot.1006 të datës 19.09.2019 për zgjedhjen e koordinatorëve bashkëpunues për edukimin e vazhdueshëm profesional në 7 regjionet e Kosovës;
- Miratimi i draft- Projekt Buxhetit të OSK-së për vitin 2025.

4.3 REGJISTRIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI I STOMATOLOGËVE

Komisioni per Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Stomatologëve ka kryer procedurat ligjore te anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit të stomatologëve.

Gjatë vitit 2024 janë:

- Anëtarësim **178** stomatolog,
- Licencim - Doktor i Stomatologjisë **167** dhe licencim specialistik **208**,
- Rilicencim – Doktor i Stomatologjisë **206** dhe rilicencim specialistik **96**,
- Të ç'anëtarësuar **39** stomatolog.



4.4 EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KVEP) gjatë vitit 2024 ka akredituar **16** (gjashtëmbëdhjetë) evente të ndryshme dhe **1** (një) është refuzuar.

1. Akreditimi i Kursit “Krijimi i buzeqeshjes me kompozite – Shikimi nga e ardhmja”, kompanisë NTP Allianz, mbajtur me datë 02.03.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

2. Akreditimi i Kursit “Aplikimi i laserit me diode: Mundësia e trajtimit minimalisht invaziv” e kompanisë NTP Allianz, mbajtur me datë 24.02.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

3. Akreditimi i kursit “Program i avansuar ne implantologji – Moduli 3”, i kompanisë NTP Allianz, mbajtur me datë 15-16.03.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

4. Akreditimi i Kongresi i trete i stomatologjise “Prishtina Dental Weekend” i Kolegjit AAB, i mbajtur me datë 17-19.05.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 20 pikë

Pjesëmarrja pasive 15 pikë

5. Akreditimi i Konferenca e VIII e Ortodonteve “Aplikimet moderne ne praktiken ortodontike”, e Shoqates se Ortodonteve te Kosoves, e mbajtur me datë 22.04.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 15 pikë

Pjesëmarrja pasive 10 pikë

6. Akreditimi i Kursit “Biomechanics in orthodontics”, i Shoqates se Ortodonteve te Kosoves, mbajtur me 23-24.04.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

7. Akreditimi i Kursit “Perdorimi i sedacionit N2O ne Stomatologji”, i kompanisë Ana Pharmaceuticals, mbajtur me datë 19-20.04.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

8. Akreditimi i kursit “Preparimi dhe cementimi i restaurimeve pa permbajtje metali tek dhembet natyral dhe tek implantet”, i kompanisë NTP Allianz, i mbajtur me datë 17-18.05.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

9. Është refuzuar akreditimi i eventit “Osteem meeting” vendi ku do te mbahej Hotel Emerald – Prishtinë me datë 15-17.06.2024 i kompanisë Neki Dnet, si pasojë e mos plotësimit të dokumentacionit sipas rregullores për EVP.
10. Akreditimi i kursit “Endodoncia klinike” , i organizuar nga kompania Bora Dental, i mbajtur me datë 07.12.2024, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

11. Akreditimi i kursit “Damon System Hands-On Course”, i organizuar nga kompania Neki Dent mbajtur me datë 30.11 dhe 01.12.2024, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

12. Akreditimi i kursit “Inovacionet ne implantologji”, i organizuar nga kompania Matkos Pharm, mbajtur me datë 09-10.11.2024, në Nice-Francë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

13. Akreditimi i kursit “Endo Puzzel: Gjithçka që duhet të dini rreth endodoncisë: Prej A deri Zh”, i organizuar nga kompania NTP Allianz, i mbajtur me datë 23-24.11.2024, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

14. Akreditimi i kursit “Restaurimet direkte me kompozit”, i organizuar nga kompania NTP Allianz, mbajtur me datë 07.12.2024, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

15. Akreditimi i Kursit “Kurs bazik mbi teknikat e llambos dhe suturimeve”, i organizuar nga Medens Pharm, mbajtur me datë 14.12.2024, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

16. Akreditimi i kursit “Endodoncia Klinike”, i organizuar nga kompania Bora Dental, mbajtur me datë 14.12.2024, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

- Gjatë vitit 2024, KEVP ka lëshuar **263** Certifikata/vërtetime mbi valorizimin e pikëve kredituese të anëtarëve të saj si dëshmi se plotësojnë kushtet për rilicencimin e tyre, ndërsa **9** raste janë refuzuar për mungesë të pikëve kredituese jo të mjaftueshme.
- **Realizimi i plan-programit të ligjëratave profesionale në kuadër të EVP-së për vitin 2024 në 7 (shtatë) rajone të Kosovës**

Janë organizuar cikle të ligjëratave profesionale me tema të ndryshme nga praktika stomatologjike. Këto ligjërata janë mbajtur nga ekspertët vendor dhe janë ndjekur nga një numër i madh i stomatologëve.



Pamje nga një ligjëratë profesionale e mbajtur në Prishtinë

Në bashkëpunim me kordinatorët për EVP, është përpiluar programit i ligjëratave profesionale dhe plani dinamik i realizimit të tyre nëpër rajonet e Kosovës (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Ferizaj) për vitin 2025.

- **Organizimi i simpoziumit profesional nga OSK**

Me 20 prill 2024 u mbajt simpoziumi profesional “Identifikimi dhe meaxhimi i faktorëve të rrezikut në praktikën stomatologjike”, në të cilën morën pjesë mbi 700 pjesëmarrës, stomatolog, teknik dhe infermiere të stomatologjisë si dhe student.

Ky simpozium i organizuar nga OSK ishte një platformë e rëndësishme për të marrë njohuri, përvoja dhe praktika të mira në fushën e emergjencave mjekësore brenda praktikës stomatologjike.



Pamje nga Simpoziumi Profesional i organizuar nga OSK

- **Botimi periodik i dy numrave të Revistës së Stomatologëve të Kosovës (RSK)**

Gjatë viti 2024 janë botuar dy numra të rinj të RSK, Vëllimi 3, Numri 1 (qershor) dhe Vëllimi 3, Numri 2 (dhjetor), në formën elektronike dhe të shtypur. Në këto dy numra RSK ka ofruar publikime të ndryshme profesionale e shkencore nga të gjitha disiplinat stomatologjike, në të cilat autorët ndër të tjerash kanë ndarë edhe përvojën e tyre profesionale nga praktika e përditshme stomatologjike. Secilit anëtarë të OSK-së nëpërmjet sms elektronik ju është dërguar linku për kyçjen në formën elektronike.



4.5 ÇËSHTJET ETIKE

Në vitin 2024 janë shqyrtuar 4 (katër) raste për pretendim të shkeljes etike. Të gjitha rastet janë shqyrtuar nga Prokurori, por që nuk janë proceduar më tutje për shkak se kanë përfunduar me aktvendim të Prokurorit. Tri raste nuk kanë qenë çështje për trajtim, ndërsa në një rast pas seancave dëgjimore prokurori ka nxjerrë aktvendim duke pushuar ankesën, meqenëse anëtari i odës ndaj të cilit është bërë ankesa, ka respektuar vendimin e Agjencionit për informim dhe privatësi të Kosovës.

Këshilli Etik gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 50 vërtetime për të kaluarën etike, 18 brenda vendit dhe 32 jashtë vendit.

Në Komisionin për çështje etike gjatë periudhës raportuese janë paraqitur shtatë raste për kërkesa të hulumtimit bio-mjekësor të cilat janë shqyrtuar nga komisioni dhe janë aprovuar.

4.6 KOMSIONI PËR SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE

Në Komisionin për Solidaritet dhe Ndihme Reciproke gjatë periudhës raportuese janë paraqitur **tre raste** që kanë kërkuar mbështetje financiare për shkaqe shëndetësore. Komisioni i ka shqyrtuar pozitivisht dhe janë lejuar mjetet nga Këshilli Drejtues.

4.7 KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA

Gjatë kësaj periudhe kohore njëvjeçare, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur pesë mbledhje të punës. Ku janë analizuar, shqyrtuar si dhe është bërë aprovimi i raporteve financiare dhe i projekt buxhetit të OSK-së, për periudhat si në vijim:

Raporti financiar 3 mujor për periudhën: 01.10.2023 – 31.12.2023,

Raporti financiar 3 mujor për periudhën: 01.01.2024 – 31.03.2024,

Raporti financiar 3 mujor për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024;

Raporti financiar 3 mujor për periudhën 01.07.2024 – 30.09.2024

Miratimi i projekt buxhetit të OSK-së, për vitin 2025.

5. MEMORANDUMET E BASHKËPUNIMIT

- **Memorandumi i bashkëpunimit me Shoqatën e Ortodontëve të Kosovës**

Me datë 12.02.2024, Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës Prof. Dr. Blerim Kamberi dhe Kryetari i Shoqatës së Ortodontëve të Kosovës Dr. Sc. Blerim Mehmeti kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila parasheh ndër tjerash organizimin e përbashkët të aktiviteteve profesionale e shkencore me qëllim të mbështetjes së procesit të ngritjes dhe avancimit profesional të ortodontëve. Në këtë marrëveshje OSK angazhohet për të njohur dhe akredituar format e ndryshme të aktiviteteve në kuadër të EVP-së, që organizohen nga Shoqata e Ortodontëve të Kosovës.

- **Marrëveshje bashkëpunimi për sigurime shëndetësore për komunitetin tonë**

Me datë 10 qershor 2024 është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë e sigurimeve “ILLYRIA”, e cila do të ofrojë 3 (tri) pako të sigurimeve shëndetësore për të gjithë anëtarët e OSK-së dhe familjarëve të tyre të ngushtë.

Varësisht nga interesimi për pakot e sigurimeve, kompania e sigurimeve “ILLYRIA” do të gjejnë forma që iu mundësojnë anëtarëve të OSK-së procedura sa më të lehta dhe të thjeshta të aplikimit.

6. AKTIVITETET TJERA

- **Realizimi i projekt-hulumtimit për “Emergjencat mjekësore në praktikën stomatologjike - sondazh i stomatologëve Kosovar”**

Në kuadër të projekt-hulumtimit të OSK-së për “Emergjencat mjekësore në praktikën stomatologjike - sondazh i stomatologëve Kosovar”, është organizuar Anketa me stomatologët nga regjistri i anëtarësisë së OSK-së.

Qëllimi i kësaj Ankete ishte mbledhja e informacionit mbi përvojën e ballafaqimit të stomatologëve në praktikën klinike me emergjencat mjekësore. Gjithashtu, synimi ishte që të konstatohen vështërsitë në menaxhimin e tyre si dhe nevojës për të marrë trajnim adekuat dhe edukim të vazhdueshëm të përditësuar.

Anketa ishte online, me projektim të programit duke përdorur në internet shërbimin Google Form dhe është dërguar secilit anëtar të OSK-së përmes adresës elektronike - emailit.

Ky hulumtim do të kontribuojë në njohuritë dhe kuptimin e përgjithshëm të emergjencave mjekësore në praktikën stomatologjike, zhvillimin e rekomandimeve për të përmirësuar menaxhimin e emergjencave mjekësore që mund të ndodhin në praktikën stomatologjike.

- **Takimi me kryetarët e OPSH-ve me karakter koordinues të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë.**

Në këtë takim u diskutua për zbatimin e legjislacionit të Odave të Profesionistëve Shëndetësor në Republikën e Kosovës.



Pamje nga takimi me kryetarët e OPSH-ve

- **Tryeza “Shëndeti Oral, të arriturat dhe sfidat”**

Me datë 16 prill 2024 në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës nën patronatin e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale u mbajt tryeza “Shëndeti Oral, të arriturat dhe sfidat”. Në këtë takim morën pjesë Dr. Vitia, Ministër i Shëndetësisë, Prof.Dr. Blerim Kamberi, kryetar i OSK-së si dhe udhëheqës dhe përfaqësues të institucioneve publike dhe private të stomatologjisë, ku u diskutua për gjendjen e shëndetit oral në vendin tonë, arritjet e deritanishme dhe sfidat për të ardhmen. Diskutimi u përqendrua në rëndësinë e promovimit të programeve parandaluese të sëmundjeve orale, nevojën për përmirësimin e infrastrukturës stomatologjike dhe për të përmirësuar aksesin në kujdesin stomatologjik publik për të gjithë qytetarët e vendit tonë.

Prof. Dr. Blerim Kamberi para të pranishmëve prezantoi dokumentin mbi strategjinë e zhvillimit të stomatologjisë të cilin dokument OSK e ka hartuar në vitin 2022.

Në këtë dokument është analizuar në mënyrë të përmblodhur e të qartë situata aktuale në sektorin e stomatologjisë në Republikën e Kosovës dhe strategjinë e qartë për të adresuar problemet dhe për të përmirësuar shëndetin oral të popullatës së Kosovës.

Kryetari në këtë takim ngriti edhe shqetësimin e një pjese të komunitetit tonë të sektorit privat, i cili po ballafaqohet me probleme serioze në fazën e rilicencimit të ordinancave private stomatologjike. Për këtë Ministri Vitia u zotua se do të merret me zgjidhjen e këtij problemi.



Pamje nga tryeza “Shëndeti Oral, të arriturat dhe sfidat”

- **Takim me përfaqësues të stomatologëve të sektorit privat**

Me datë 23.04.2024, Kryetari i OSK-së Prof. Dr. Blerim Kamberi me nënkryetarin Prof. Ass. Ali Gashi priten në takim përfaqësues të stomatologëve të sektorit privat që kanë ngritur shqetësimin e tyre lidhur me udhëzimin administrativ nr. 02/2023 i cili ka të bëjë me kushtet dhe procedurat për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore në institucionet private dhe të cilët janë duke u ballafaquar me vështirësi të ndryshme në fazën e rilicencimit të ordinancave private stomatologjike.



Pamje nga takimi me përfaqësues të stomatologëve të sektorit privat

- **OSK merr statusin e anëtarit vëzhgues në Federatën evropiane të rregullativave për stomatologji (FEDCAR)**

Me datë 16 maj 2024 në Trogir të Kroacisë me ftesë të kryetarit të FEDCAR Dr. Hrvoje Pezo, kryetari i OSK-së, Prof. Dr. Blerim Kamberi dhe Dr. Bleron Faiku, kanë marrë pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të FEDCAR, në të cilën Oda e Stomatologëve të Kosovës ka marr statusin e anëtarit vëzhgues në këtë organizatë.

FEDCAR është një organizatë evropiane e rregullativave në stomatologji, e cila u themelua në vitin 2004 me seli në Bruksel, aktualisht numëron 22 shtete të Evropës.

Statusi i anëtarit vëzhgues në FEDCAR është një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të praktikave tona me standardet evropiane dhe një mundësi për të sjellë ndryshime dhe përmirësime të rëndësishme në stomatologjinë e vendit tonë.

Statusi i anëtarit vëzhgues në një entitet kaq prestigjioz si FEDCAR, rrit besueshmërinë ndaj stomatologjisë në vendin tonë, dhe do të jetë një mundësi për të përparuar, për të mësuar dhe për të ndarë njohuri me komunitetin stomatologjik evropian.



Pamje nga pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme të FEDCAR

- **Takimi me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Me datë 21 maj 2024 në ambientet e OSK-së, Kryetari Prof. Dr. Blerim Kamberi së bashku me nënkryetarët, pritën në takim grupin punues të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Qëllimi i këtij takimi ishte monitorimi dhe zbatimi i ligjit aktual për odat e profesionistëve shëndetësorë. Grupi punues u interesua për tema të caktuara të implementimit të ligjit, për problemet aktuale të moszbatimit të tij si dhe për sfidat e OSK-së për të ardhmen.

U diskutua edhe për shqetësimin e komunitetit tonë lidhur me UA nr. 02/2023 i cili ka të bëjë me kushtet dhe procedurat për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore në institucionet private, me të cilat ata janë duke u ballafaquar në fazën e rilicencimit të ordinancave private stomatologjike.



Pamje nga takimi me komisionin parlamentar për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

- **Ripërsëritja e kërkesës së komunitetit tonë për plotësim ndryshimin e UA nr 2/2023 për kushtet dhe procedurat për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore në institucionet private**

Gjatë komunikimit të drejtpërdrejt me Ministrin e Shëndetësisë, Dr. Vitia, Kryetari i OSK-së ka përsëritur kërkesën e anëtarëve të OSK-së mbi domosdoshmërinë e plotësim ndryshimit të këtij Udhëzimi Administrativ i cili në formën si është aktualisht, do të vështirësojë dhe pamundësojë ushtrimin e veprimtarisë stomatologjike në sektorin privat.

Me këtë rast, Kryetari i ka dorëzuar edhe opinionin e OSK-së mbi dispozitat taksative të cilat duhet të ndryshohen në këtë Udhëzim Administrativ.

- **Takimi me ekspert ligjor të projektit “Mbështetje për njohjen e kualifikimeve profesionale”**

Me datë 28 maj 2024 Kryetari i OSK-së Prof. Dr. Blerim Kamberi priti në takim ekspertët ligjor nga Zyra e BE në kuadër të projektit “Mbështetje për njohjen e kualifikimeve profesionale”, i financuar nga BE.

Qëllimi i këtij projektit është harmonizimi i njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale me Acquis të BE-së. Acquis është organ i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që është i detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Përafrimi i legjislacionit kombëtar në Kosovë duke përfshirë strukturën institucionale me Acquis të BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale, do t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës të ushtrorjnë profesionin e tyre në një shtet tjetër anëtar të BE-së, e me këtë edhe profesionin e stomatologut, pas anëtarësimit të Kosovës në BE. Për më tepër, direktivat e BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale janë bazë e procesit të Berlinit, i cili do të mundësojë lëvizjen e lirë të profesionistëve në vendet e Ballkanit Perëndimor.



Pamje nga takimi me ekspert ligjor të projektit

- **Pjesëmarrja në Kongresin Botëror të Stomatologjisë, 12-15 shtator 2024**

Në kuadër të Kongresit Botëror të Stomatologjisë të mbajtur në Stamboll të Turqisë me 12-15 shtator 2024, Kryetari i OSK-së Prof.Dr. Blerim Kamberi dhe Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës Dr. Ilmi Kryeziu morën pjesë në forumet e ndryshme të Parlamentit Botëror të Stomatologjisë.

Në forumin për edukimin e vazhdueshëm profesional diskutimet ishin të përqëndruar në nevojën për të zhvilluar dhe përmirësuar programet e edukimit të vazhdueshëm profesional për profesionistët e stomatologjisë. Rëndësia e këtij forumi ishte në ndihmën e krijimit të mundësive për zhvillimin e aftësive dhe për të mbajtur profesionistët të përditësuar me trendet më të fundit dhe praktikatat më të mira në fushën e tyre.



- **U mbajt punëtorja për hartimin e Kodit Etik dhe Deontologjisë Stomatologjike**

OSK ka organizuar punëtorinë tre ditore për hartimin e Kodit Etik të ri që ka rëndësi të madhe sepse siguron udhëzime profesionale për doktorin e stomatologjisë për të vepruar me integritet, duke ndihmuar në shmangien e konflikteve etike dhe siguron standarde të larta të kujdesit stomatologjik.



Pamje nga punëtorja për hartimin e Kodit Etik dhe deontologjisë stomatologjike

- Takim me dekanen e Fakultetit të Mjekësisë Dentare të Tiranës Prof. Asoc. Silvana Bara

Me datë 18.10.2024, kryetari i OSK-së Prof. Dr. Blerim Kamberi priti në takim dekanen e Fakultetit të Mjekësisë Dentare të Tiranës Prof. Asoc. Silvana Bara.

U zotua në avancimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi në format e ndryshme, parasëgjithash në fushën e edukimit të vazhdueshëm profesional, në shkëmbimin e ligjëruesve, njohjen dhe akreditimin e eventeve profesionale nga ana e OSK-së.



7. RAPORTI I PASQYRAVE FINANCIARE

Është siguruar vazhdimësia e stabilitetit financiar të OSK-së;

Është bërë regjistrimi në tërësi i mjeteve kryesore dhe inventarit në përdorim dhe është futur në programin financiar ProData;

Është bërë auditimi i pasqyrave financiare dhe auditimi funksional për vitin 2023. Në auditimin financiar, auditori i jashtëm ka dhënë opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare të OSK-së. Po ashtu, në aspektin funksional të organeve të OSK-së auditori i jashtëm ka dhënë opinion të pakualifikuar dhe pa ndonjë theksim të çështjes lidhur me funksionimin e organeve të OSK-së.

Tabelat me poshtë paraqesin pasqyrimin e të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të Odës, për periudhën njëvjeçare (2024). Në kategorinë e të hyrave (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) gjithsejt kanë qenë **227,792.74€**, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) janë shpenzuar gjithsejt **151.898.03€**.

RAPORT I PËRGJITHSHËM FINANCIAR

PERIUDHA RAPORTUESE 01.01.2024 – 31.12.2024

I. TË HYRAT:

1 - NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

| 1-TË HYRAT | | TM-1 | TM-2 | TM-3 | TM-4 | REALIZIMI TM1-TM4 |
|--|--|------------|------------|------------|------------|----------------------|
| 1 | Të hyrat nga anëtarimi | 25,281.17€ | 58,500.00€ | 19,408.47€ | 12,165.02€ | 115,354.66€ |
| 2 | Të hyrat nga licencimi | 5,100.00€ | 10,000.00€ | 12,000.00€ | 12,100.00€ | 39,200.00€ |
| 3 | Të hyrat nga rilicencimi | 8,040.00€ | 4,700.00€ | 5,400.00€ | 4,680.00€ | 22,820.00€ |
| 4 | Të hyrat nga EVP | 3,060.00€ | 6,017.50€ | 600.00€ | 5,976.00€ | 15,653.50€ |
| 5 | Të hyrat nga Kodi Etik | 660.00€ | 150.00€ | 480.00€ | 360.00€ | 1,650.00€ |
| 6 | Të hyrat nga mbajtja e provimeve vlerësuese | 200.00€ | 800.00€ | 500.00€ | 900.00€ | 2,400.00€ |
| 7 | Të hyrat tjera (duplifikim i Licencës, ndërrim i ID,) | 20.00€ | 55.00€ | 45.00€ | 90.00€ | 210.00€ |
| 8 | Të hyrat nga faksimilat | 885.00€ | 1,125.00€ | 1,300.00€ | 1,470.00€ | 4,780.00€ |
| 9 | Të hyrat nga hulumtimet bio-mjekësore | - | 300.00€ | 150.00€ | - | 450.00€ |
| 10 | Të hyrat nga gjobat për vonesë në pagesë të anëtarësisë | 1,410.00€ | 900.00€ | 360.00€ | 585.00€ | 3,255.00€ |
| 11 | Të hyrat nga simpoziumi | 1,045.00€ | 9,465.00€ | - | - | 10,510.00€ |
| 12 | Të hyrat nga donacionet për revistë | - | 1,500.00€ | - | - | 1,500.00€ |
| 13 | Të hyrat nga norma e interesit të fituar (afatizimi i mjeteve) | - | - | 1,714.69€ | - | 1,714.69€ |
| 14 | Pagesat gabimisht | 20.00€ | - | - | - | 20.00€ |
| I. GJITHSEJ të hyrat në llogarinë kryesore: | | | | | | 219,517.85€ |

2 - NË NËNLLOGARINË BANKARE TË FONDIT PËR SOLIDARITET

| 1-TË HYRAT | | TM-1 | TM-2 | TM-3 | TM-4 | REALIZIMI TM1:TM4 |
|---|---|---------|---------|-----------|-----------|----------------------|
| 1 | Të hyrat nga pagesat e gjobave për Ri-Licencim | 950.00€ | 580.00€ | 780.00€ | 1,175.20€ | 3,485.20€ |
| 2 | Të hyra nga norma e interesit të fituar (afatizimi i mjeteve) | - | - | 1,714.69€ | - | 1,714.69€ |
| 3 | Transfer nga gjobat për vonesë në pagesë të anëtarësisë | - | - | - | 3,075.00€ | 3,075.00€ |
| II. GJITHSEJ të hyrat në nënlllogarinë e fondit për solidaritet: | | | | | | 8,274.89€ |

| | |
|--|--------------------|
| Gjithsej të hyrat nga: Llogaria kryesore + Llogaria e Solidaritetit (I+II) | 227,792.74€ |
|--|--------------------|

II. SHPENZIMET:

1 - SHPENZIMET NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

| 2-SHPENZIMET | | TM-1 | TM-2 | TM-3 | TM-4 | SHPENZIM ET TM1-TM4 |
|--------------|--|------------|------------|------------|------------|---------------------------|
| 1 | Shpenzimet për paga dhe meditare | 20,057.97€ | 17,326.15€ | 18,310.90€ | 23,800.62€ | 79,495.75€ |
| 2 | Tatimi në paga dhe meditare | 1,161.42€ | 2,413.82€ | 2,673.58€ | 2,222.00€ | 8,470.82€ |
| 3 | Kontribute pensionale | 1,309.20€ | 2,704.44€ | 3,058.84€ | 2,598.38€ | 9,670.86€ |
| 4 | Shpenzimet e faksimilave | 484.95€ | 497.67€ | 810.90€ | 699.60€ | 2,493.12€ |
| 5 | Qeraja dhe tatimi ne qera | 1,252.74€ | 1,315.16€ | 1,629.88€ | 1,582.41€ | 5,780.19€ |
| 6 | Anëtarësimi në FDI dhe ERO | 746.92€ | - | - | - | 746.92€ |
| 7 | Auditimi Financiar/Funksional 2023 | - | 2,500.00€ | - | - | 2,500.00€ |
| 8 | Komunale (rrymë,ujë,mbeturina,ngrohje) | 113.01€ | 93.06€ | 124.41€ | 139.24€ | 469.72€ |

| | | | | | | |
|--|---|-----------|-----------|-----------|-----------|--------------------|
| 9 | Administrative/Operacionale të zyrës: web,materiale të ndryshme pune për zyre | 702.28€ | 713.87€ | 1,142.17€ | 1,430.15€ | 3,988.47€ |
| 10 | Reprezentacion, telefon dhe internet, derivate, taxi | 823.33€ | 813.89€ | 579.58€ | 1,227.50€ | 3,444.30€ |
| 11 | Botimi i Revistës së Stomatologëve të Kosovës | - | - | 2,487.50€ | 2,487.50€ | 4,975.00€ |
| 12 | Punëtoritë | - | 212.10€ | 1,278.00€ | 2,511.00€ | 4,001.10€ |
| 13 | Shpenzimet e mirëmbajtjes së webfaqes dhe programit financiar ProData | 1,499.00€ | - | - | - | 1,499.00€ |
| 14 | Paisje dhe Inventar | 489.00€ | - | 699.00€ | 706.80€ | 1,894.80€ |
| 15 | Shpenzime për organizimin e simpoziumit | - | 3,990.60€ | - | - | 3,990.60€ |
| 16 | Sigurime shëndetësore | 156.40€ | 469.20€ | 469.20€ | 351.90€ | 1,446.70€ |
| 17 | Provizione bankare | 196.90€ | 137.50€ | 171.60€ | 216.60€ | 722.60€ |
| 18 | Shpenzimet e kuvendit | 1,295.30€ | - | - | 1,364.50€ | 2,659.80€ |
| 19 | Biletat e transportit për dy ligjëruesit e ftuar në simpozium | 520.00€ | - | - | - | 520.00€ |
| 20 | Udhëtime zyrtare | 620.00€ | 1,393.54€ | 1,767.00€ | 904.45€ | 4,684.99€ |
| 21 | Kthim i mjeteve | 85.00€ | 40.00€ | 15.00€ | - | 140.00€ |
| 22 | Norma e interesit të fituar nga afatizimi i mjeteve | - | - | 1,714.69€ | - | 1,714.69€ |
| 23 | Transfer nga gjobat për vonesë në pagesë të anëtarësisë | - | - | - | 3,075.00€ | 3,075.00€ |
| I. GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë kryesore të OSK-së: | | | | | | 148,384.43€ |

2 - SHPENZIMET NË LLOGARINË E FONDIT PËR SOLIDARITET

| 2-SHPENZIMET | | TM-1 | TM-2 | TM-3 | TM-4 | SHPENZIM ET TM1:TM4 |
|---|---|-------|-------|-----------|---------|---------------------------|
| 2.1. | Përkrahje financiare nga fondi për Solidaritet i OSK-së | - | - | 3,000.00€ | 500.00€ | 3,500.00€ |
| 2.2. | Provizione bankare | 3.00€ | 3.00€ | 3.80€ | 3.80€ | 13.60€ |
| II. GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë e fondit për Solidaritetit të OSK-së: | | | | | | 3,513.60€ |

Gjithsej Shpenzimet nga: Llogaria kryesore + Llogaria e Solidaritetit (I+II)

151,897.92€

1 – Llogaria kryesore bankare e OSK-së

SALDO ME DATË: **01.01.2024**.....119,884.85€
 GJITHSEJ TË HYRAT.....**219,517.85€**
 AFATIZIMI I MJETEVE.....100,000.00€
 GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....439,402.70€
 GJITHSEJ SHPENZIMET.....**(148,384.43€)**
 SALDO ME DATË **31.12.2024**.....**291,018.27€**

1-Gjithsej të hyrat.....**219,517.85€**2-Gjithsej Shpenzimet.....**(148,384.43€)**3-Bilanc pozitiv financiar.....**71,133.42€****2- Nënlogaria e Fondit për Solidaritet**

SALDO ME DATË: **01.01.2024**.....4,643.01€
 GJITHSEJ TË HYRAT**8,274.89€**
 GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....12,917.90€
 GJITHSEJ SHPENZIMET.....**(3,513.60€)**
 SALDO ME DATË:**31.12.2024**.....**9,404.30€**

1-Gjithsej të hyrat.....**8,274.89€**2-Gjithsej Shpenzimet.....**(3,513.60€)**